

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nis takimet informuese me institucionet për unifikimin e procedurave të publikimit të vendeve të lira të punës

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, nisi takimet konsultative me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura, për unifikimin e procedurave të publikimit të pozicioneve të lira të punës, në portalin e-Albania.



Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi) theksoi se unifikimi i procedurave të publikimit të fazave të rekrutimit, nga të gjitha tipologjitë e institucioneve, pjesë e shërbimit civil, garanton respektimin e dispozitave ligjore e nënligjore, që normojnë institutin e rekrutimit.



Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil deklaroi se takimet informuese dhe një modul trajnimi do të zhvillohen në vijimësi me institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, që kanë kërkuar të asistohen nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, gjatë aplikimit të praktikës së re të publikimit të pozicioneve të lira të punës.



“Parimi i transparencës dhe i barazisë në procesin e rekrutimit, janë elementë të rëndësishëm në vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së konkurrimit. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i ka mbikëqyrur vazhdimisht këto procese, duke kërkuar nga

institucionet, respektimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore që normojnë këtë aspekt të administrimit të marrëdhënies në shërbimin civil”- deklaroi Komisioneri.

Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, z. Klevis Hysa prezantoi praktikën e re të publikimit të pozicioneve të lira të punës, që do të realizohet përmes portalit qeveritar “E-Albania”.

Gjatë takimit informues, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kërkoi të njëjët me problematikat e hasura nga vetë institucionet në aplikimin e metodologjisë së re të publikimit të fazave të rekrutimit në shërbimin civil.

Përfaqësuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të Bashkive: Tiranë e Vlorë përcollën shqetësimet e tyre, në aplikimin e praktikës së re të publikimit të pozicioneve të lira të punës, dhe kërkuan të asistohen nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.



Institucioni i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil do të mbikëqyrë të gjithë procesin e publikimit të fazave të rekrutimit në shërbimin civil, për të garantuar se janë zbatuar dispozitat ligjore dhe nënligjore, që normojnë institutin e rekrutimit dhe do të vijojë takimet informuese me institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

